



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:254688
Datë: 01.03.2023
Numri i dokumentit: 04030150

E. Rev.nr. 1/2022

GJYATA SUPREME E KOSOVËS , kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Shukri Sylejmani dhe Fejzullah Rexhepi, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit , K. e S. "A. W.", me seli në Zvicër, të cilën e përfaqëson I. A. L.L.C. nga P., Besnik Nikqi - Avokat nga P., kundër të paditurës K. e S. "S.", me seli në P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson S. D. nga P., për shkak të regresit, në shumën e përgjithshme prej 13,376.84€, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.55/2021 datë 07.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më 23.02.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurës K. e S. S.' në P., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.55/2021 datë 07.07.2021.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.55/2021 datë 07.07.2021 është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Ekonomike V .C.nr 282/2019 , i datës 26.01.2021 ashtu që

në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit është aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses K. e S. "A. W.", me seli në Zvicër, e paraqitur kundër të paditurës K. e S. "S.", me seli në P., ashtu që në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit është detyruar e paditura K. e S. "S.", me seli në P., që paditëses K. e S. "A. W.", me seli në Zvicër në emër të regresit nga baza e sigurimit auto kasko t'ia paguaj shumën prej 13,376.84€ të gjitha me kamatë prej 8% në vit, duke filluar nga data 04.04.2016 deri në pagesën definitive të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Në pikën III të dispozitivit është detyruar e paditura që paditëses në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguaj shumën prej 2,247.000 €

Gjykata e shkallës së dytë ka refuzuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë .

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afat ligjor ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të njëjtin ta ndryshoj dhe të aprovoj kërkesëpadinë e paditëses deri në shumën prej 8,551.69 € , me kamatë prej 8% nga data 27.05.2019 , si datë e paraqitjes së padisë, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadiës të refuzohet si e pabazuar

Në përgjigje në revizion paditësi ka propozuar që revizioni i të paditurës të refuzohet si i pabazuar dhe aktgjykimi i goditur të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 e lidhur me nenin 505 të LPK-së, ka gjetur se:

Revizioni i të paditurës, është i pabazuar .

Në procedurë të zhvilluar pranë gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar se në aksidentin e komunikacionit që ka ndodhur me datë 27.12.2018, paditësja ka paguar të siguruarit të tij nga sigurimi auto kasko shumën prej 15,437.13 CHF . Aksidentin e ka shkaktuar i siguruari i të paditurës me automjetin "M. B. " me targa të regjistrimit Në këtë aksident të komunikacionit dëm material ka pasur në automjetin e tij i siguruari i paditësit , i cili shpërblimin e dëmit realizon te paditësi nga baza e sigurimit kasko , në shumën prej 15,347.13 CHF € Paditësi kërkon rimbursim të dëmit nga e paditura ,në shumën prej 13,376.84 € , i siguruarit i të cilës është përgjegjës për dëmin e shkaktuar. E paditura nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadiës ,por vetëm lartësinë e shumës së kërkuar në emër të rimbursimit .

Gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të administruara dhe gjendjes së vërtetuar faktike ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses për rimbursim është e bazuar në shumën e aprovuar të kërkesëpadisë, pasi që ekziston detyrimi i të paditurës që sipas të drejtës së rimbursimit t'ia paguajë paditëses shumën prej 13,376.84 €, në kuptim të nenit 960 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta zyrtare e RSFJ nr. 04/L-077) me kamatë prej 8% duke llogaritur nga data 04.04.2019 ,deri në pagesën definitive. Gjykata e shkallës së parë vlerësimin e lartësisë së dëmit e ka bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit të makinerisë S. Sh. .

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur ka obliguar të paditurën të paguajë paditëses në emër të rimbursimit shumën prej 13,376.84 €,

Gjykata Supreme vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët, në gjendjen e vërtetuar faktike, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, ashtu që gjykata e shkallës së dytë drejt ka vepruar kur ka refuzuar ankesën e të paditurit ,sa i përket detyrimit të paditurës të rimburoj shumën prej 13,376.84 €, dhe se aktgjykimi në këtë pjesë nuk është përfshirë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 215 të LPK.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson si të pabazuara thëniet e revizionit të paditurës se gjykatat e instancës më të ulët nuk kanë arsyetuar në aktgjykimet e veta se në bazë të cilave prova cilat fakte i kanë vërtetuar, pse dhe si i kanë vërtetuar ato fakte, cilat prova i kanë shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato e që kjo paraqet shkelje nga neni 160.4 të LPK-së, ngase sipas vlerësimit të gjykatës së revizionit me aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë vlerësuar të gjitha provat në bazë të nenit 8 të LPK-së, dhe janë dhënë arsye të mjaftuara se me cilat prova cilat fakte janë vërtetuar dhe në bazë të kësaj gjendjeje të vërtetuar faktike në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat materiale juridike. Aktgjykimet e gjykatave të instancës të ulët ,nuk janë përfshirë me shkelje nga neni 182 (n) të LPK-së ngase të njëjtat përmbajnë arsye të plota për faktet vendimtare, të vlefshme për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike të cilat janë të pranueshme edhe për këtë Gjykatë.

Thëniet e revizionit të paditurës se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore , nga neni 182.paragrafi 1 të LPK-së , sepse në mënyrë të gabuar ka zbatuar dispozitën e nenit 532.1 të LPK-ës ,Gjykata Supreme i vlerësoi si të pabazuara, nga arsyeja se shkelje nga neni 182 paragrafi 1 të LPK-së, mund të jenë shkaqe për paraqitjen e revizionit me kusht, që këto shkelje të jenë shkaktuar në procedurën sipas ankesës në gjykatën e shkallës së dytë .

Gjykata e revizionit i vlerësoi si të pabazuara thëniet e revizionit lidhur me ekspertizën nga eksperti N. Sh. dhe kërkesën për caktimin e super ekspertizës mbi vlerësimin, e dëmit ,ngase pretendimet e tilla kanë qenë objekt i shqyrtimit edhe para gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë ,të cilat në aktgjykimet e tyre kanë dhënë arsye të mjaftueshme , të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Në procedurë pranë gjykatës së shkallës së parë ka qenë kërkesa e palës së paditur për caktimin e super ekspertizës ,e cila është refuzuar si propozim i pa arsyetuar dhe i pa specifikuar se për të cilat çështje duhet të sqarohet eksperti tjetër. Gjatë procedurës përveç ekspertizës së dorëzuar me shkrim , eksperti është dëgjuar dhe në pyetjet e parashtruara nga palët, ka dhënë plotësim të ekspertizës me shkrim dhe është përgjigj në të gjitha pyetjet e parashtruara nga palët.

Kalkulimi i lartësisë së dëmit nga eksperti N. Sh. është bërë sipas çmimit dhe kriterëve që vlejné në Kosovë , e që sipas vlerësimit edhe të Gjykatës Supreme janë reale dhe të pranueshme dhe se gjykatat e instancës ma të ulët kanë dhënë arsyetim të mjaftueshëm dhe nuk ka nevojë që të njëjtat të përsëriten nga kjo gjykatë.

Sa i përket pretendimeve të revizionit se gjykatat e instancës ma të ulët në mënyrë të gabuar kanë zbatuar të drejtën materiale ,Gjykata Supreme i vlerëson si të pabazuara, nga arsyeja se e paditura nuk ka kontestuar bazën e kërkesëpadisë , por ka kontestuar lartësinë e kërkesëpadisë, të cilën gjykatat e instancës më të ultë e kanë vërtetuar në bazë të ekspertizës të ekspertit M.sc N. Sh. mbi vlerësimin e dëmit në automjetin dhe plotësimin të ekspertizës të këtij eksperti.

Gjykata Supreme e Kosovës , vlerëson se gjykata e instancës më të ulët në mënyrë të drejt ka zbatuar dispozitën e nenit 939 të LMD-së, ngase , ka gjykuar shumën reale të dëmit të shkaktuar në automjetin e të siguruarit të paditësit i cili është shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të shkaktuar nga i siguruari i të paditurës dhe është arritur qëllimi i shpërblimit të dëmit të shkaktuar që gjendja materiale e dëmtuesit të sjellët në gjendjen para shkaktimit të dëmit .Me pagimin e dëmit nga paditësi të siguruarit të tij sipas dispozitës në fjalë, kalon te paditësi e

drejta të rimbursoj dëmin nga e paditura dhe është detyrimi i të paditurës t'ia paguajë shumën prej 10,500 € paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës me qëllim të evitimit të divergjencave në praktikën gjyqësore lidhur me ligjin e aplikueshëm për llogaritjen e kamatës , lartësinë dhe periudhën e llogaritjes së kamatës ,dhe duke vepruar sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës sipas lëndës KI 35\18 datë 6,janar 2020 dhe duke u bazuar në nenin 26 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat (nr06\L-054) në Mbledhjen e përgjithshme , më datën 1.12.2020,për të përcaktuar qëndrimet parimore , ka nxjerr Mendim Juridik për kamatën. Në bazë pikës X të këtij mendimi juridik, për kërkesat e kreditorëve për rimbursim të dëmit nga të gjitha bazat e përgjegjësisë kur kreditorët kanë të drejtë në rimbursim të dëmit , kamata rrjedh nga dita e parashtrimit të kërkesës së kreditorit për rimbursim(e pranuar nga debitori)kurse në rast të mos parashtrimit të kërkesës, atëherë nga data e parashtrimit të padisë deri në pagesën e plotë. Sipas pikës I të këtij Mendimi juridik lidhur me ligjin e aplikueshëm ,është përcaktuar se për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para datës 20.12.2012, për kamatën zbatohen dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta zyrtare e RESFJ -së, nr 29\78,39\85 ,57\89). Sipas pikës XI të këtij mendimi juridik është harmonizuar praktika gjyqësore edhe në rastet e kërkesave për kompensim të dëmit apo mbulimit të shpenzimeve për rastin e siguruar (kompensimi i rastit të siguruar) me policë vullnetare (sigurimi vullnetar) lartësia e kamatës caktohet sipas pikës IV dhe VI të këtij mendimi juridik varësisht se cili ligj është në zbatim në kohën kur paraqitet rasti i siguruar. Sipas pikës IV të këtij mendimit juridik për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para datës 20.12.2012, shkalla\lartësia e kamatëvonesës caktohet si për mjete e deponuara në bankë , mbi një vit , pa destinim të caktuar .Ndërsa sipas pikës VI të këtij mendimi juridik për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur pas datës 19.12. 2012 . shkalla, lartësia e kamatëvonesës vjetore për të gjitha kërkesat do të caktohet në lartësi prej 8 % , përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se aksidenti i komunikacionit në të cilën i siguruari i paditësit ka pësuar dëmin material në automjetin e tij ‘‘B. C. Z...’’ ka ndodhur më datën 4.6.2007 ,dhe marrëdhënia juridiko civile ka lindur në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr 29\78,39\85,,57\89) sipas të cilit lartësia e kamatëvonesës caktohet si për mjetet e deponuara në bankë , mbi një vit , pa destinim të caktuar neni 277 LMD. Për kërkesat e kreditorëve për rimbursim të dëmit ,kamata rrjedh nga dita e parashtrimit të kërkesës për rimbursim ,ndërsa në rastet të mos parashtrimit të kërkesës , atëherë kamata llogaritet nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën e plotë .Paditësi kërkesën

për rimbursim e ka paraqitur te e paditura më datën 12.5.2009 dhe se kamata rrjedh nga dita e parashtrimit të kërkesës për rimbursim.

Zbatimi i gabuar i të drejtës materiale qëndron në faktet se , si është thënë më lartë, kërkesëpadia e paditësit për shpërblim të dëmit si dhe padia është paraqitur në kohën kur ka hyrë në fuqi Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve të RSFJ-së. Kamata e aprovuar nga gjykatat e instancës më të ulët, ligjërisht nuk aplikohet në kontestet për rimbursim të borxhit por vetëm në kërkesat e trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për shpërblim të dëmit në procedurën jashtëgjyqësore ashtu siç parashihet në nenin 26 të Ligjit në fjalë dhe nenin 5.1 të Rregullit të BQK-së nr. 3 mbi ndryshimin e Rregullit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia të datës 25 shtator 2008, në të cilat dispozita thirren gjykatat e instancës së ulët. Ato kamata të cilat i kanë aplikuar gjykata e shkallës së parë dhe të dytë janë të parapara me qëllim të disiplinimit të kompanive siguruese në raportet e sigurimit ndaj kërkesave për dëmshpërblim të personave të dëmtuar të cilat kërkesa kompanitë e sigurimeve janë të detyruara që t'i trajtojnë me urgjencë brenda afateve të parapara sipas dispozitave të lartpërmendura.

Paragrafi 7 i nenit 26 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, përjashton zbatimin e kamatës prej 12% për rimbursim borxhi, kamatë kjo e paraparë vetëm për mostrajtim dhe rënien në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për dëmshpërblim nga sigurimi i detyrueshëm nga auto përgjegjësia . Nga kjo rezulton se paditësi ka drejtë vetëm në kamatëvonesë të paraparë me nenin 277 LMD jo edhe në kamatë ‘të kualifikuar’ sipas dispozitave të zbatuara nga gjykatat e shkallës së parë dhe asaj të dytë. Meqenëse, paditësja me parashtrësën e datës 12.5.2009 ka kërkuar rimbursim të borxhit nga e paditura, rezulton se e paditura nga kjo datë ka rënë në vonesë kur nuk e ka mbushur detyrimin brenda afatit deri në pagesën definitive. Për rastet e kërkesave për kompensimin e dëmit apo të mbulimit të shpenzimeve për rastin e siguruar (Kompensimin e rastit të siguruar) me policë vullnetare (sigurimi vullnetar)lartësia e kamatës caktohet sipas ligjit që ka qenë në fuqi e që në rastin konkret është LMD e RSFJ-së e (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr 29\78,39\85,,57\89), . I siguruari i paditësit ka pasur sigurimin kasko që është policë vullnetare dhe se nuk mund të llogaritet kamata sipas nenit 5.1 të Rregullit të BQK-së nr. 3 mbi ndryshimin e Rregullit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia të datës 25 shtator 2008, pasi që kjo kamatë llogaritet për sigurimet e detyrueshme nga auto përgjegjësia .

Nga arsyet e dhëna më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 222 lidhur me nenin 224.1 të LPK-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

E.Rev.nr.1/2022 datë 23 shkurt 2023

Kryetar i kolegjit,
Erdogan Haxhibeqiri